



This project is financed by the European Union

SHËRBIMI PUBLIK DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE në BUJQËSI DHE ZHVILLIMIN RURAL

Monitorimi i Parimeve të RAP
në Sektorët e Politikave - Raporti për Shqipërinë

Publikimi:

**Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore
në sektorin e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural**

Publikuesi:

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim – IDM

Autoret:

**Eldisa Zhebo, Instituti për Ndryshim dhe Lidërsip në Shqipëri (INLSh)
Entela Kaleshi, Instituti për Ndryshim dhe Lidërsip në Shqipëri (INLSh)**

Grafika:

Eduart Cani

Tiranë, korrik 2022

**FUSHA RAP: SHËRBIMI PUBLIK DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI I POLITIKAVE: BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL
INSTITUCIONI: MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**



Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përgjegjësia për përmbajtjen dhe informacionin e këtij publikimi i përket vetëm autoreve, publikuesit dhe rrjetit Think for Europe. Opinionet e shprehura në këtë publikim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian. Për më shumë informacion, luteni të shkoni në: www.par-monitor.org



This project is financed by
the European Union



institut alternativa



TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE RAPORTI	5
I. HYRJE	6
I.1 Çfarë monitoron WeBER-i dhe përse?	6
1.2 Struktura e Raportit	6
II. ANALIZA	7
2.1. Metodologjia	7
2.2. Analiza	8
III. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM	17
SHTOJCAT	18
Akses falas te kërkesat për informacion	18
Intervistat	18
Burimet nga interneti	18
Shtojca 1 - 5	19

SHKURTESA

OShC	Organizatat e Shoqërisë Civile
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
DAP	Departamenti i Administratës Publike
KLI	Kërkesa për Liri Informimi
KPP	Komiteti i Përhershëm i Pranimit
RAP	Reforma në Administratën Publike
ShPMBNj	Shërbimi Publik dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
MBZhr	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
WeBER	Fuqizimi i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor për një Administratë Publike të Reformuar

PËRMBLEDHJE RAPORTI

Në kuadër të projektit WeBER 2.0 - Fuqizimi i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor për një Administratë Publike të Reformuar, zbatuar nga rrjeti Think for Europe (TEN) dhe financuar nga Bashkimi Evropian, Instituti për Ndryshim dhe Liderhip në Shqipëri (INLSH) realizoi një studim për zbatimin e parimeve të reformës së administratës publike për shërbimet publike dhe menaxhimin e burimeve njerëzore (ShPMBNJ) në sektorin e zhvillimit bujqësor dhe rural në Shqipëri.

Raporti analizon se si i zbaton Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Shqipëri Shërbimet Publike dhe Parimet e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në sektorin e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, për të shqyrtuar se si dhe në ç'nivel përfshihen parimet e administratës publike në politikat sektoriale.

Qëllimi i këtij raporti monitorimi, hartuar nga organizatat e shoqërisë civile, është të ngrëjë kapacitetet monitoruese të OShC-ve për të ushtruar presion nga poshtë-lart në mënyrë që parimet e qeverisjes së mirë të integrohen në politikat sektoriale. Njëkohësisht, ky raport synon t'i stimulojë institucionet sektoriale në Shqipëri që të mendojnë në mënyrë më proaktive rreth integritit të parimeve në politikat e tyre.

Monitorimi sektorial në fushën e ShPMBNJ-së realizohet sipas Parimit 3 të SIGMA-s - rekrutimi i nëpunësve publikë bazohet mbi meritën dhe trajtimin e barabartë në të gjitha fazat. Lista e kontrollit të ShPMBNJ-së përbëhet nga 6 kërkesa të cilat janë elemente kyç të procesit të rekrutimit që ka në themel konkurrimin publik për vendet e lira në shërbimin civil (me përjashtim të shërbimit civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues). Kjo listë vlerëson disponueshmërinë publike të informacionit lidhur me shërbimin publik, procedurat e punësimit të nëpunësve civilë të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, përbërjen e komiteteve të përzgjedhjes, dhe publikimin e vendimeve të komiteteve të përzgjedhjes, për të parë nëse vendin e punës e fitojnë vërtet kandidatët me renditjen më të mirë dhe nëse janë bërë publike arsyet për zbatimin e procedurave të anulimit të konkurrimit publik.

Raporti paraqet vlerën e treguesit kundrejt kritereve të vlerësimit për secilën kërkesë. Raporti përmban edhe rekomandime për veprime të ardhshme lidhur me ShPMBNJ-në për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Të dhënat u mblodhën për periudhën janar 2021-prill 2022.

Gjetjet theksojnë nevojën për përmirësimin e masave që të garantohet një proces sa më i hapur dhe transparent për sa u përket të dhënave në dispozicion të publikut lidhur me zbatimin e politikës së rekrutimit në shërbimin civil.

I. HYRJE

1.1 Çfarë monitoron WeBER-i dhe përse?

Monitorimi i fushës së Shërbimit Publik dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (ShPMBNj) realizohet kundrejt parimit 3 të SIGMA-s.

Parimi 3: Rekrutimi i nëpunësve publikë ka në themel meritën dhe trajtimin e barabartë në të gjitha fazat.

Lista e kontrollit të ShPMBNj-së përbëhet nga 6 kërkesa të cilat janë elemente kyç të procesit të rekrutimit që ka në themel konkurrimin publik për vendet e lira në shërbimin civil. Fillon me praktikatat e monitorimit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me lajmërimin e vendeve të lira në shërbimin civil (me përjashtim të shërbimit civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues) dhe nëse kandidatëve të mundshëm u është dhënë kohë e mjaftueshme për të aplikuar. Përbërja e komiteteve të përzgjedhjes monitorohet duke vlerësuar nëse anëtarët i plotësojnë standardet e profesionalizmit dhe paanshmërisë. Për sa u përket vendimeve të komiteteve të përzgjedhjes, vlerësohet nëse janë transparente, duke dhënë informacion të detajuar për performancën e të gjithë kandidatëve të përzgjedhshëm që kanë marrë pjesë në procesin e rekrutimit. Më pas, vijohet me vlerësimin e vendimeve përfundimtare për emërimin e nëpunësve civilë duke përcaktuar nëse vendi i punës është fituar vërtet nga kandidatët me renditjen më të mirë. Kërkesa e fundit e ShPMBNj-së që vlerësohet në këtë raport është publikimi i arsyeve për anulimin e procedurave të konkurrimit.

Për sa i përket mbledhjes së të dhënave, qasja e listës së kontrollit mbështetet te rishikimi i faqes së internetit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, portalit të centralizuar të shërbimit civil për të gjitha rekrutimet në administratën publike që menaxhohet nga Departamenti i Administratës Publike, faqes së internetit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit, llogarive të institucioneve të vlerësuara në mediat sociale dhe plotësimin e kërkesave për qasje të lirë në informacion të të gjitha dokumenteve që nuk janë të disponueshme online.

1.2 Struktura e Raportit

Raporti nis me paraqitjen shkurtimisht të metodologjisë dhe vijon më pas me analizimin e çdo kërkesë. Analiza e çdo kërkesë përfshin metodologjinë e vlerësimit dhe vetëvlerësimit.

Raporti paraqet edhe vlerësimin e përgjithshëm për çdo kërkesë duke e përmbysur analizën me përcaktimin e një prej tre alternativave, në përputhje me udhëzimet e vlerësimit që janë: "Kërkesa është përmbushur plotësisht", "Kërkesa është përmbushur pjesërisht", ose "Kërkesa nuk është përmbushur".

Raporti jep në fund rekomandimet e përgjithshme për përmirësime në fushën e Shërbimit Publik dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (ShPMBNj) në Shqipëri.

II. ANALIZA

2.1. Metodologjia

Monitorimi i WeBER-it në fushën e ShPMBNJ-së përfshin shërbimin civil të qeverisë qendrore, sikurse përkufizohet në legjisllacionin e zbatueshëm (kryesisht në ligjin për shërbimin civil) dhe realizohet në përputhje me parimet SIGMA. Qasja ka në themel faktorë të rëndësishëm për shoqërinë civile nga këndvështrimi i hapjes së qeverisë dhe transparencës së sistemit të shërbimit civil dhe aksesueshmërisë së të dhënave për zbatimin e politikës së rekrutimit në shërbimin civil.

Ky raport përfshin gjetje nga studimi dhe analiza e legjisllacionit, dokumenteve dhe informacionit për shërbimin civil, të disponueshme në internet në kuadër të programit të transparencës dhe informacionit të marrë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nëpërmjet lirisë për të bërë kërkesë për informacion.

Studimi u realizua gjatë periudhës mars-maj 2022. Kampioni për konkurrimet në shërbimin civil për nëpunësit civilë të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues u mor gjatë periudhës janar 2021-prill 2022.

Metodat kryesore të përdorura në këtë vlerësim janë:

1. Shqyrtimi i legjisllacionit kombëtar në fuqi

Institucioneve të qeverisë qendrore që janë pjesë e shërbimit civil u kërkohet të zbatojnë me rigorozitet Ligjin Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", ndryshuar, si dhe aktet nënligjore përkatëse në fuqi si:

- Ligji Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".
- VKM-ja Nr. 108/2014 "Për planin vjetor në shërbimin civil".
- VKM-ja Nr. 242, datë 18.3.2015, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", ndryshuar me VKM-në nr. 748, datë 19.12.2018.
- Udhëzimi Administrativ nr. 2, datë 27.3.2015, i Departamentit të Administratës Publike "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur".
- Ligji Nr. 152/2013 për nëpunësit civilë (ndryshuar me Ligjin Nr. 178/2014 dhe Ligjin Nr. 41/2017). Ky ligj zbatohet për çdo punonjës civil që ushtron funksione publike në një institucion të caktuar të administratës publike.

2. Analiza e të dhënave të disponueshme për publikun që i përkasin periudhës 1 janar 2021 - 30 prill 2022 nga faqet zyrtare.

- Departamenti i Administratës Publike (faqja zyrtare e internetit e DAP-it)
- Faqja Zyrtare e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Faqja Zyrtare e Facebook-ut e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Faqja zyrtare e AKPA-s (Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi)

3. Depozitimi i dy kërkesave për akses të lirë në informacion të të gjitha dokumenteve që nuk janë në dispozicion të publikut në internet. (Kërkesë dërguar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural më 11 maj 2022 dhe 5 qershor 2022 (dërguar me e-mail dhe zyrtarisht në kopje fizike, në po të njëjtat data)

Kuadri metodologjik mbështetet te gjashtë kërkesat që u përkasin elementeve kyç të proceseve të mëposhtme të rekrutimit bazuar te konkurrimet publike për vendet e lira në shërbimin civil:

- Kërkesa 1: Informacioni rreth konkurremeve publike është masivisht në dispozicion të publikut
- Kërkesa 2: Kandidatët e mundshëm kanë kohë të mjaftueshme për të dorëzuar aplikimet në procesin e konkurrimit publik
- Kërkesa 3: Përbërja e komiteteve të përzgjedhjes është profesionale dhe e paanshme
- Kërkesa 4: Transparenca e rezultateve të komiteteve të përzgjedhjes është e sigurt
- Kërkesa 5: Vendet e punës fitohen vërtet nga kandidatët me renditjen më të mirë
- Kërkesa 6: Publikut i vihen në dispozicion arsyet e anulimit të procedurave të konkurrimit publik

2.2. Analiza

Kërkesa 1: Informacioni për konkurrimet publike është masivisht në dispozicion të publikut.

Qasja ndaj kësaj kërkesë merr parasysh vlerësimin e praktikave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me publikimin e njoftimeve të konkurrimit publik për plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil (me përjashtim të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues).

Sipas Ligjit Nr. 152/2013 për nëpunësit civilë (ndryshuar me Ligjin Nr. 178/2014 dhe Ligjin 41/2017)- Departamenti i Administratës Publike (pika 1 ndryshuar, shtuar germa "h/1", në pikën 2 me ligjin nr. 178/2014) - c) mbikëqyr zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore

Neni 18 i këtij ligji përkufizon procedurat për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil

1. Administrimi i shërbimit civil bazohet te plani vjetor i pranimit.
2. Këshilli i Ministrave e miraton planin e pranimit në institucionet e administratës shtetërore jo më vonë se fundi i shkurtit. Planet vjetore të miratuara sipas kësaj pike publikohen.
3. Këshilli i Ministrave miraton:
 - a) rregullat për përmbajtjen, periudhën e miratimit dhe mënyrën e publikimit të planeve të pranimit.
 - b) procedurat e pranimit për përgatitjen dhe miratimin e planit të përgjithshëm të pranimit në institucionet e administratës publike.

Referenca për analizimin e kësaj kërkesë përfshiu edhe Vendimin Nr. 242, datë 18.3.2015, Kreu II.

- Pika Nr. 5 e VKM-së Nr. 242/2015 kërkon që institucionet e administratës shtetërore ta shpallin procedurën e pranimit për çdo kategori të shërbimit civil në faqen zyrtare të DAP-it dhe në portalin e "Shërbimit Kombëtar të Punësimit" dhe shpallja duhet të qëndrojë e publikuar të paktën deri në fund të procedurës së pranimit.
- Pika Nr. 7 e VKM-së Nr. 242/2015 kërkon që institucionet publike, krahas mënyrave të detyrueshme të shpalljeve të përkufizuara në pikën 5 dhe 6 të Kreut II të këtij vendimi, të mund të përdorin mënyra alternative të shpalljes së konkurrimit në faqen e internetit të institucionit, si dhe mënyra të tjera që konsiderohen të përshtatshme për shpalljen, të njohura nga ligji i zbatueshëm.

Për të marrë informacionet e nevojshme, studiuesit kanë rishikuar një sërë shpalljesh për konkurrime publike që janë publikuar në faqen e internetit të DAP-it, për plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil (niveli i ulët dhe i mesëm) në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZhR) nga 1 janari i 2021-shit deri më 30 prill 2022. Zbuluam se ishin publikuar 15 shpallje për 19 vende të lira.

Arsyeja se përse ka më shumë vende pune se njoftime është se në ato shpallje kishte më shumë se një vend të lirë. (Për më tepër detaje rreth këtyre njoftimeve, shihni tabelën në shtojcë. Pozicione me më shumë se 1 vend pune.)

- Publikimi numër 3540 (linku i shpalljes <http://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/3032>) ka dy vende pune.
- Publikimi numër 3759 (linku i shpalljes <http://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/3256>) ka dy vende pune.
- Publikimi numër 3799 (linku i shpalljes <http://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/3296>) ka dy vende pune.

Së dyti, studiuesit rishikuan edhe kanalet e mëposhtme mbarëkombëtare për të përcaktuar nëse shpalljet për vende të lira i qenë vënë në dispozicion publikut masivisht, nëpërmjet mënyrave të ndryshme të reklamimit.

- Profili zyrtar i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Facebook -<https://www.facebook.com/MinistriaeBujqesisedheZhvillimitRural>
- Faqja zyrtare e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: <https://bujqesia.gov.al/> dhe linku për vendet e lira: <https://bujqesia.gov.al/njoftime-per-vende-vakante/>
- Faqja zyrtare e Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi: Linku i AKPA-s: <https://akpa.gov.al/> dhe linku për kërkim pune në AKPA: <https://puna.gov.al/>

Nuk u gjet informacion në tre burimet e tjera më lart lidhur me shpalljet për vendet e lira të punës për kampionin tonë. (Shihni Shtojcën 2, 3 dhe 4)

Së treti, ekipi i ka dërguar MBZhR-së kërkesa për liri informimi (KLI) për të kuptuar arsyet e mundshme të mungesës së njoftimeve të vendeve të lira, krahas atyre të shpallura në portalin e DAP-it. (Kërkesat KLI paraqiten në fillim të Shtojcave dhe nuk përsëriten më tej në vlerësime të tjera të kriterëve më poshtë) Sipas MBZhR-së, publikimi i njoftimeve për vende të lira pune bëhet vetëm në portalin administrata.gov.al.

Kriteret e vlerësimit: Nëse të gjitha shpalljet e konkurrimeve publike reklamohen nëpërmjet të paktën tri mjeteve mbarëkombëtare, përfshirë ato të parashikuara ligjërisht, vlerësimi është "Kërkesa është përmbushur plotësisht". Nëse shpalljet e konkurrimeve publike reklamohen në mënyrë jo-konsistente me të paktën tri mjete në shumicën e rasteve, pra më shumë se 50%, por jo të gjitha, vlerësimi është "Kërkesa është përmbushur pjesërisht". Nëse shpalljet e konkurrimeve publike reklamohen duke përdorur më pak se tri mjete mbarëkombëtare, pavarësisht përqindjes së rasteve, vlerësimi është "Kërkesa nuk është përmbushur".

Përmbledhje e gjetjeve: Informacioni për konkurrimet publike është i disponueshëm vetëm në faqen zyrtare të DAP-it (shihni Shtojcën 1). Nuk ka informacione të tjera të disponueshme në burime të tjera (shihni Shtojcën 2, 3 dhe 4)

Vlerësimi Përfundimtar Shpalljet e konkurrimeve publike në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për plotësimin e vendeve të lira të punës për nëpunësit civilë të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues nuk janë të disponueshme gjerësisht sepse janë publikuar vetëm në faqen e internetit të Departamentit të Administratës Publike. **Kërkesa nuk është plotësuar.**

Kërkesa 2: Kandidatët e mundshëm kanë kohë të mjaftueshme për të dorëzuar aplikimet në procesin e konkurrimit publik.

Qasja ndaj kësaj kërkesë merr parasysh nëse njoftimet e konkurrimit publik, të analizuar në kërkesën 1, përmbajnë afate të arsyeshme për t'u dhënë mjaftueshëm kohë të gjithë kandidatëve të mundshëm që të përgatisin dhe të aplikojnë për vende të lira pune në shërbimin civil (niveli i ulët dhe i mesëm).

Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Administratës Publike në Shqipëri rregullohen nga Ligji 152/2013 "Për nëpunësin civil". Sipas këtij Ligji, Departamenti i Administratës Publike përgatit planin vjetor të pranimit për institucionet e administratës shtetërore dhe aplikimin për vendet e lira në shërbimin civil në institucionet e administratës shtetërore, që përfshijnë Kryeministrinë, ministritë e linjës dhe institucionet e tyre të pavarura, përfshirë edhe degët e tyre territoriale dhe prefekturat.

Sipas DAP-it, aplikimet për vendet e lira të punës në shërbimin civil mund të bëhen online në adresën zyrtare të Departamentit të Administratës Publike www.rekrutimi.administrata.al/shpalljet. Në këtë faqe, të gjitha palët e interesuara mund të marrin informacion për vendet e lira, afatet, kriteret e aplikimit dhe dokumentacionin e kërkuar. Për të hyrë në sistem, duhet krijuar fillimisht llogaria personale ku do të ngarkohen të gjitha dokumentet e nevojshme. Sapo të jetë krijuar llogaria, mund të vijohet me aplikimin online për pozicionet/grupet e pozicioneve për të cilat është i interesuar personi. Aktualisht, kur përfundohen me sukses të gjithë hapat e aplikimit, në e-mailin e regjistruar nga palët e interesuara dërgohet automatikisht një e-mail njoftimi nga Departamenti. Ky e-mail konfirmon se është shprehur interes për aplikimin për pozicionin/grupin e pozicioneve. Poshtë çdo njoftimi shfaqen edhe datat e provimit, lista e kandidatëve fitues etj. Për sa u përket rezultateve të aplikimit, çdo aplikues njoftohet automatikisht me e-mail.

Referenca për analizën e kësaj kërkesë u bazua mbi VKM-në Nr. 242, Kreu II, pika 9, e cila kërkon që njoftimi të jetë i hapur për të gjithë nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet që janë pjesë e shërbimit civil. Dokumentacioni duhet dorëzuar deri në datën e përcaktuar në njoftimin për konkurs. Kjo datë përcaktohet duke u siguruar që afati për dorëzimin e dokumentacionit të jetë më pak se 10 (dhjetë) ditë kalendrike nga dita e parë e njoftimit: a) në faqen zyrtare të DAP-it dhe portalin e "Shërbimit Kombëtar të Punësimit", për institucionet e administratës shtetërore.

Bazuar te njoftimet publike të analizuar në kërkesën 1, studiuesi vlerësoi nëse këto njoftime i përmbanin afatet që lejonin të paktën dhjetë (10) ditë kalendrike nga dita e parë e njoftimit për dorëzimin e dokumentacionit nga të gjithë kandidatët e mundshëm për t'u përgatitur dhe aplikuar për vendin e lirë.

Nga të dhënat e disponueshme në portalin e DAP-it (shihni Shtojcën 1 dhe Figurën 1 më poshtë) për të gjitha njoftimet për pozicionin, nuk ka datë publikimi për shpalljen e vendeve të lira, por vetëm një numër reference për çdo shpallje.

3541

departamenti
dap
Administratës Publike

Shpallje për lëvizje paralele Pranim në shërbimin civil

Në kategorinë ekzekutive

Lloji i diplomës "Mbrojtje Bimësh", niveli minimal i diplomës "Master Shkencor"

Në zbatim të nenit 22 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, si dhe të kreut II, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

1. Specialist në Sektorin e Shëndetit dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe OMGJ, në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - Kategoria: III-b

Për të dy procedurat (lëvizje paralele, Pranim në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

Lëvizje paralele

30.03.2021

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

Pranim në shërbimin civil

08.04.2021

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin/et si më sipër është:

- Harton kuadrin ligjor në fushën e OMGJ-ve dhe produkteve plehëruese, me qëllim përaftrimin e legjislacionit në këtë fushë me legjislacionin e BE-së.
- Propozon plane dhe iniciativa për fushën e OMGJ-ve dhe produkteve plehëruese, si dhe drejton zhvillimin e programeve të nevojshme për të siguruar gjithëpërfshirje dhe qëndrueshmëri në punën e sektorit.
- Propozon masa për një zhvillim të orientuar e të qëndrueshëm të sektorit në fushën e OMGJ-ve dhe produkteve plehëruese, në përputhje me politikën ekonomike të programit të qeverisë dhe ministrisë.
- Ndjek zbatimin e legjislacionit në fushën e OMGJ-ve dhe produkteve plehëruese.
- Monitoron situatën e OMGJ-ve dhe produkteve plehëruese, në bashkëpunim me strukturat e tjera që vepronë në këtë fushë.
- Përgatit prioritetet e sektorit për PKIE dhe ndjek realizimin.
- Ndjek rekomandimet e Raportit Progresit deri në plotësimin e tyre.

Figura 1- ilustrimi i një njoftimi publik në faqen zyrtare të DAP-it ¹

Duke qenë se të dhënat e nevojshme nuk ishin bërë publike, MBZHR-së iu dërgua një KLI pikërisht për këtë gjë. Sipas Ministrisë, lidhur me procedurat e pranimit në shërbimin civil, bazuar te Neni 22 i Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", ndryshuar, si dhe Vendimi Nr. 243, datë 18.3.2015, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", ndryshuar, të gjitha procedurat e punësimit (niveli i ulët deri mesatar) në institucionet e administratës shtetërore që janë pjesë e shërbimit civil, janë zbatuar nëpërmjet procedurës së rekrutimit të zhvilluar nga DAP-i si institucion përgjegjës.

Kriteret e vlerësimit: Nëse afati ligjor minimal është të paktën 10 ditë pune ose më shumë pas shpalljes dhe kjo gjë zbatohet në praktikë në të gjitha konkurrimet publike, vlerësimi që jepet është "Kërkesa është përmbushur plotësisht". Nëse afati ligjor minimal është më pak se 10 ditë pune, por në praktikë zgjat më tepër në të paktën 50% të konkurrimeve publike, vlerësimi që jepet është "Kërkesa është përmbushur pjesërisht". Nëse afati ligjor minimal është më pak se 10 ditë pune dhe ky afat zbatohet në praktikë në mbi 50% të konkurrimeve publike, vlerësimi që jepet është "Kërkesa nuk është përmbushur". Nëse afati ligjor minimal nuk respektohet, vlerësimi që jepet është automatikisht "Kërkesa nuk është përmbushur".

Përmbledhja e gjetjeve - Bazuar te informacioni i vënë në dispozicion për publikun, nuk mund të përcaktohet nëse kërkesa prej 10 ditësh afat është përmbushur.

Vlerësimi përfundimtar - Kërkesa nuk është përmbushur.

Kërkesa 3: Përbërja e komiteteve të përzgjedhjes është profesionale dhe e paanshme.

Qasja ndaj kësaj kërkesë merr parasysh nëse përbërja e komitetit të përzgjedhjes është profesionale dhe e paanshme në praktikë. Në këtë kuadër:

- përbërje profesionale do të thotë se personat e caktuar në komitetin e përzgjedhjes vijnë nga institucione përgjegjëse sektoriale (organe që zbatojnë procedurën e konkurrimit publik), organe të tjera shtetërore që lidhen me pozicionin e punës së shpallur, zyrat/agjencitë qendrore të MBNj-së (nëse ka), si dhe profesionistë/ekspertë të pavarur të fushës (nga akademia, organizatat profesionale ose të ngjashme).

1 <http://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/3033>

- përbërje e paanshme do të thotë se janë marrë masat për parandalimin e konfliktit të interesit për çdo anëtar të komitetit të përzgjedhjes.

Vlerësuesit kanë shqyrtuar fillimisht kërkesat e legjislacionit kombëtar për sa i përket përbërjes së komitetit të përzgjedhjes dhe parandalimit të konfliktit të interesit. Kërkesat e legjislacionit kombëtar shpjegohen në këto burime:

Në VKM-në Nr. 242, Kreu II, pikat 10- 19 i referohen lëvizjes paralele të nëpunësve civilë.

Pika 10. Konkurrimi për procedurën e lëvizjes paralele përfshin dy faza:

- a) verifikimin paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
- b) vlerësimin e kandidatëve, ku përfshihen vlerësimi i përvijës në punë, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet pozitive dhe intervista e strukturuar me gojë.
- Pika 11. Njësia përgjegjëse, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të dokumenteve, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.
- Pika 12. Kandidatët, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, renditen në një listë nga njësia përgjegjëse sipas rendit alfabetik.
- Pika 13. Lista paraprake e verifikimit të kandidatëve, shpallet brenda të njëjtit afat të përcaktuar në pikën 11, të kreut II të këtij vendimi, në faqen e internetit të DAP-it dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", për institucionet e administratës shtetërore.
- Pika 16 kërkon që pas përfundimit të procedurës së mësipërme, njësia përgjegjëse të shpallë listën e verifikimit të kandidatëve dhe brenda 2 (dy) ditëve kalendarike të urdhërojë ngritjen e Komitetit të Pranimit për Lëvizjen Paralele (KPLP), i cili ka në përbërje tre anëtarë, si më poshtë: a) 1 (një) përfaqësues nga institucioni për të cilin është shpallur vendi i lirë, i të njëjtit nivel ose i një niveli më të lartë nga pozicioni që rekrutohet, kur është e mundur, i caktuar nga DAP-i; b) eprorin direkt; c) 1 (një) përfaqësues nga DAP-i për institucionet e administratës shtetërore.
- Pika 17 kërkon që anëtarët e caktuar sipas pikës 16, me përjashtim të rasteve të pengesave ligjore, janë të detyruar të marrin pjesë në Komitetin e Pranimit për Lëvizjen Paralele, ku janë caktuar.
- Në rast pamundësie të pjesëmarrjes së anëtarëve të Komitetit të Pranimit për Lëvizjen Paralele, pika 18 i kërkon njësisë përgjegjëse që të marrë masa për zëvendësimin e tyre me anëtarë të tjerë. Sipas pikës 19, DAP-i, mund të autorizojë edhe nëpunës të tjerë civilë të institucioneve të tjera për të kryer detyrat e përfaqësuesit të DAP-it në Komitetin e Pranimit për Lëvizjen Paralele.

VKM-ja Nr. 243, datë 18.03.2015, ndryshuar me VKM-në Nr. 746, datë 19.12.2018, për pranimet në shërbimin civil tek institucionet e administratës shtetërore (pika 1, Kreu III) kërkon që DAP-i, për institucionet e administratës shtetërore, të ngrejë Komitetin e Përhershëm të Pranimit (në vijim KPP), për pranimin për çdo grup të administrimit të përgjithshëm/të posaçëm.

3. Në përbërje të Komitetit të Përhershëm të Pranimit janë pesë anëtarë, si më poshtë:

- a) 1 (një) anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson **KPP**-në;
- b) Për institucionet e administratës shtetërore - 2 (dy) anëtarë nga nëpunësit civilë të institucioneve të administratës shtetërore, pjesë e kategorisë së mesme drejtuese;
- c) 2 (dy) ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimit për grupet përkatëse.

4. Nëpunësit civilë të institucioneve të administratës shtetërore të përzgjedhur nga DAP-i, me përjashtim të

rasteve të pengesave ligjore, janë të detyruar të marrin pjesë në Komitetet e Përhershme të Pranimeve ku janë caktuar.

5. Ekspertët zgjidhen nga njësia përgjegjëse, për secilën KPP, duke marrë parasysh karakteristikat e secilit grup pozicionesh, për të cilat do të zhvillohet procedura e konkurrimit.

6. Ekspertët zgjidhen mes pedagogëve të universiteteve apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, ekspertëve të licensuar të fushave të ndryshme apo ekspertëve që vijnë nga profesionet e rregulluara dhe që kanë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë në atë pozicion pune/profesion, përcaktuar sipas specifikave të Komitetit të përzgjedhur nga DAP-i.

Shqyrtimi i dokumenteve publike tregoi se nuk ka asnjë informacion të disponueshëm lidhur me përbërjen e Komitetit të Përzgjedhjes ose informacion të mëtejshëm të detajuar rreth nivelit të profesionalizmit dhe karrierës së këtyre anëtarëve.

Për të gjitha shpalljet e konkurrimeve të shqyrtuara, të cilat janë vënë në dispozicion sipas Kërkesës 1, vlerësuesi i ka kërkuar MBZhR-së informacion shtesë për anëtarët e komitetit të përzgjedhjes dhe përkatësinë e tyre, si dhe prova se masat për parandalimin e konfliktit të interesit janë zbatuar si duhet, sipas kuadrit ligjor. Për sa i përket informacionit për anëtarët e komitetit të përzgjedhjes dhe kriterëve të përzgjedhjes, MBZhR-ja qartësoi se, duke iu referuar pikës 12 të Kreut VII të VKM-së Nr. 243, datë 18.3.2015, komiteti ngrihet me këta anëtarë:

- a) 1 (një) përfaqësues nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit, kur është e mundur, i të njëjtit nivel ose i një niveli më të lartë se pozicioni që rekrutohet.
- b) eprori direkt.
- c) 1 (një) përfaqësues nga DAP-i për institucionet e administratës shtetërore.

Sipas MBZhR-së, deri në prill të 2022-shit, nuk ka pasur raste konflikti interesi për anëtarët e komiteteve përkatëse. Për më tepër, Ministria informoi se për çdo procedurë konkurrimi, përfaqësuesi i DAP-it në komitetin e përzgjedhjes sigurohet që kryetari dhe anëtarët ta nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit sipas dispozitave ligjore në fuqi. Megjithatë, Ministria nuk i ka vënë në dispozicion dokumentet e nevojshme për të konfirmuar zbatimin e dispozitave përkatëse ligjore.

Kriteret e vlerësimit: Nëse anëtarësia e komitetit të përzgjedhjes është profesionale dhe e paanshme në të gjitha rastet e vëzhguara, vlerësimi që jepet është “Kërkesa është përmbushur plotësisht”. Nëse ka prova që, në pak raste, anëtarësia e komitetit të përzgjedhjes nuk është plotësisht profesionale ose e paanshme, vlerësimi që jepet është “Kërkesa është përmbushur pjesërisht”. Nëse ka prova që, në shumicën e rasteve, anëtarësia e komitetit të përzgjedhjes nuk është plotësisht profesionale ose e paanshme, vlerësimi që jepet është “Kërkesa nuk është përmbushur”.

Përmbledhja e gjetjeve - Bazuar te informacioni i disponueshëm, vlerësuesi informohet nga Ministria se procedura e komitetit të përzgjedhjes ndjek ligjet kombëtare dhe se DAP-i sigurohet që anëtarët e komitetit të përzgjedhjes ta kenë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit sipas dispozitave ligjore. Megjithatë, Ministria nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokumentacion për të konfirmuar zbatimin e dispozitave ligjore dhe rrjedhimisht, sipas kriterëve të vlerësimit, “Kërkesa nuk është përmbushur”.

Vlerësimi përfundimtar - “Kërkesa nuk është përmbushur” sepse institucioni nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokumentacion që vërteton zbatimin e duhur të ligjit.

Kërkesa 4: Transparencë për rezultatet e komitetit të përzgjedhjes.

Qasja ndaj kësaj kërkesë merr parasysh nëse janë vënë në dispozicion të publikut rezultatet e procedurave të konkurrimit publik, që kanë përfunduar gjatë vitit të fundit kalendarik. Me rezultate nënkuptohen akte ose

vendime përzgjedhjeje, ku të ketë informacione për performancën e të gjithë kandidatëve të përshtatshëm (renditjet sipas pikëve/vlerësimeve të përgjithshme, në varësi të kërkesave të legjislacionit kombëtar).

Ekipi i kërkimit shqyrtoi legjislacionin kombëtar për të përcaktuar kërkesat e publikimit dhe përmbajtjen e detyrueshme të akt-vendimeve, si dhe dispozitat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, kur bëhen publike vendimet e përzgjedhjes, nëse ka (do të përdoren për analizë dhe jo për vlerësim përfundimtar). Kërkesat e legjislacionit kombëtar shpjegohen në këto burime: VKM-ja 242, Kreu II, pika 31 dhe Kreu III, pika 39 kërkojnë që rezultatet e procesit të publikohen në faqen e internetit të DAP-it dhe në Portalin Kombëtar të Punësimit.

Sipas provave të disponueshme në faqen zyrtare të DAP-it (shtojca 1), vlerësuesi vëzhgoi sa më poshtë lidhur me njoftimet e 15 vendeve të lira

- Dy kandidatë janë punësuar për shkak të lëvizjes paralele, por pikët e kandidatëve fitues nuk janë publikuar. (Referojuni shpalljes nr. 4049 dhe shpalljes nr.4039)
- Ndërkohë, në fazën e "Pranimit në Shërbimin Civil", janë të disponueshme pikët e 8 kandidatëve (Referojuni shpalljeve nr. 3540; 3542; 3543; 3546; 3799; 3823).
- Pjesa tjetër e shpalljeve të vendeve të lira janë tërhequr pa fitues (shihni Kërkesën 6)

Kriteret e vlerësimit: Nëse të gjitha vendimet e përzgjedhjes janë të në dispozicion të publikut, vlerësimi që jepet është "Kërkesa është përmbushur plotësisht". Nëse shumica, por jo të gjitha vendimet e përzgjedhjes janë në dispozicion të publikut, vlerësimi që jepet është "Kërkesa është përmbushur pjesërisht". Nëse janë në dispozicion të publikut më pak se gjysma e vendimeve të përzgjedhjes, vlerësimi që jepet është "Kërkesa nuk është përmbushur".

Përmbledhja e gjetjeve - Nga informacionet në dispozicion të publikut del se nga 10 vendime janë bërë publike 8 të tilla.

Vlerësimi përfundimtar - Transparenca për rezultatet e komiteteve të përzgjedhjes është e pjesshme. Kërkesa është përmbushur pjesërisht.

Kërkesa 5: Kandidatët me renditjen më të lartë janë ata që e fitojnë vërtet vendin e punës.

Qasja ndaj kësaj kërkesë merr parasysh nëse pozicionet në shërbimin civil u jepen vërtet kandidatëve më të mirë që marrin pjesë në konkurrimin publik. Me kandidatë më të mirë nënkuptohen kandidatët me renditjen më të lartë nga të gjithë kandidatët e përshtatshëm që kanë marrë pjesë në konkurrim, pas procesit të përzgjedhjes. Për këtë kërkesë merren parasysh të gjitha procedurat e përfunduara të konkurimit publik të përcaktuara në kërkesën 4.

Ekipi i kërkimit shqyrtoi fillimisht legjislacionin kombëtar për të përcaktuar përjashtimet e justifikuara nga pikëpamja ligjore lidhur me dhënien e vendit të punës një kandidati jo me renditjen më të mirë (p.sh diskriminimi pozitiv/veprime afirmuese, nëse kandidati me renditjen më të mirë e refuzon pozicionin e punës e të tjera të ngjashme). Legjislacioni kombëtar që shërben si referencë për këtë kërkesë është:

VKM-ja Nr. 242, Kreu II, pikat 22 dhe 23

- Pika 22 kërkon që komiteti, në përfundim të vlerësimit, të përzgjedhë kandidatin që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).
- Pika 23 kërkon që kandidatët me pikë të barabarta të renditen sipas këtyre kriterëve:
 - a) në rast se njëri prej kandidatëve përfshihet në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara,

atëherë ai përzgjidhet i pari në raport me kandidatin tjetër; b) në rast se kandidatët janë të gjinive të ndryshme, atëherë i jepet përparësi kandidatit që i përket gjinisë më pak të përfaqësuar për atë kategori në institucionin për të cilin konkurrohet. Gjinia më pak e përfaqësuar përcaktohet nga njësia përgjegjëse; c) në rast se nuk mund të aplikohet asnjëra nga alternativat e mësipërme, atëherë renditja e kandidatëve me pikë të barabarta bëhet nëpërmjet shortit.

VKM-ja Nr. 242, Kreu III, pika 31

- Sipas pikës 31, kandidat fitues shpallet ai/ajo që renditet i pari/e para ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve). Në rast se kandidatët marrin pikë të barabarta, zbatohen dispozitat e pikës 24 të Kreut II të këtij vendimi.

Nga rishikimi i njoftimeve të DAP-it, janë gjetur prova që tregojnë se, nga 15 njoftime pune, në shërbimin civil janë pranuar 8 kandidatë me mbi 70 pikë (shihni Shtojcën 5.1). Ndërkohë, sipas analizës së parashikuar në Kërkesën 4, për dy kandidatët që janë punësuar për shkak të procesit të "lëvizjes paralele" nuk ka prova për pikët përfundimtare. (Shihni kolonën e "Gjetjeve" në tabelën e Shtojcës 1)

Për sa i përket kërkesës së paraqitur nga Ministria për kopjen e emërimeve për proceset e përfunduara, vlerësuesi u informua se të gjithë kandidatët fitues gjatë periudhës nën shqyrtim i kanë marrë vërtet pozicionet e punës, ndërsa për sa u përket provave, MBZHR-ja qartësoi sipas VKM-së Nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishtme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit" se akti i emërimit është pjesë e dosjes së personelit, që ka karakter individual dhe për rrjedhojë konfidencial.

Vlerësuesi kërkoi më tej emrat e 10 kandidatëve fitues nga 15 njoftimet e publikuara nga DAP-i (Shtojca 1) për të parë nëse figuronin si të punësuar në MBZHR ose në agjenci të tjera të varura nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

